



Pranimar / Dorezuar Prinjaljen / Pradato Received / Delivered	07.11.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Organi / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMAD	6774	2022	.114



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.819/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.819/2022 të datës 23.09.2022, të parashtruar nga grup ankuesish:

të cilët me autorizim i përfaqëson Avokatja me adresë Prishtinë, kundër organit të punësimit/Ministria e Financës Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 07.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.819/2022, e datës 23.09.2022 e parashtruar nga grup ankuesish:

A r s y e t i m

Ankuesit, që të gjithë të punësuar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me datë 23.09.2022 përmes përfaqësuesit të autorizuar kanë parashtruar ankesë me numër protokollit 5633/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.819/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kompensimin e pagave jubilarë, shujtave ditore, dhe shtesave tjera, për periudhën kohore 06.09.2017 deri me 06.09.2022 sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, Ligjit për Shërbyesit Civil dhe Ligjit për Paga.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë

28.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, ndërsa me datë 05.10.2022 ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesve me nr. protokollin 5633/2022 të datës 23.09.2022 e parashtruar nga ankuesit përmes përfaqësueses së tyre me autorizim në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën me Nr. protokollin 1913/2022 e datës 06.09.2022 e parashtruar nga ankuesit tek organi i punësimit; Akt Emërimi i Y.S. me nr. protokollin 111 i datës 28.12.2017; Vendim i Y.S. për përfundimin e marrëdhënies së punës i datës 20.01.2021; Vërtetim i Y.S. me nr. protokollin 5435 i datës 15.11.2016; Autorizim nga Y.S. për Avokaten T.B.B. i datës 21.04.2021; Akt Emërimi i B.I. me nr. protokollin 104 i datës 01.01.2012; Vendim i B.I. për përfundimin e marrëdhënies së punës i datës 31.01.2020; Autorizim nga B.I. për Avokaten T.B.B. i datës 21.04.2021; Vërtetim për N.N. me nr. protokollin 1513 i datës 30.06.2021; Akt Emërimi i N.N. me nr. protokollin 76 i datës 10.02.2015; Vendim i N.N. për përfundimin e marrëdhënies së punës i datës 11.03.2019; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 28.09.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokollin 5894/2022 e datës 05.10.2022; Lista e pagave për Y.S. prej datës 01.09.2017 deri 30.09.2017; Lista e pagave për Y.S. prej datës 01.12.2020 deri 31.12.2020; Përgjigje në ankesë me numër protokollin 5988/2022 e datës 07.10.2022; E-mail nga A.B. për C.Z. i datës 07.10.2022; E-mail nga A.H. për A.B. i datës 07.10.2022; Akt Emërimi i N.M. me nr. protokollin 14 i datës 19.02.2016; Lista e pagave për N.M. prej datës 01.08.2017 deri 31.08.2017; E-mail nga A.B. për C.Z. i datës 07.10.2022; E-mail nga A.H. për A.B. i datës 07.10.2022; Lista e pagave për N.N. prej datës 01.08.2017 deri 31.08.2017; E-mail nga A.B. për C.Z. i datës 07.10.2022; Akt Emërimi i B.I. me nr. protokollin 253 i datës 16.04.2014; Lista e pagave për B.I. prej datës 01.08.2017 deri 31.08.2017; Lista e pagave për B.I. prej datës 01.08.2017 deri 31.08.2017; Lista e pagave për B.I. prej datës 01.08.2017 deri 31.08.2017; E-mail nga C.Z. për T.B. i datës 31.10.2022; Autorizim nga N.M për Avokaten T.B.B. i datës 26.07.2022; E-mail nga T.B. për C.Z. i datës 01.11.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa e ankuesve është e palejuar , *sepse:*

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankuesit janë të punësuar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, tani Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, respektivisht ankuesi sipas Akt Emërimin me numër protokollin 111 të datës 28.12.2017 ka qenë i punësuar në pozitën e punës *Zyrtar për Shërbime të Punësimit*, ankuesi sipas Akt Emërimin me numër protokollin 14 të datës 19.02.2016 në pozitën e punës *Zyrtar për Përgatitjen dhe Realizimin e Pagesave*, ankuesi sipas Akt Emërimin me numër protokollin 76 të datës 10.02.2015 në pozitën e punës *Zyrtar i Infrastrukturës*, dhe ankuesja sipas Akt Emërimin me numër protokollin 253 të datës 16.04.2014 në pozitën e punës *Zyrtare për Financa*.

Po ashtu nga shkresat e lëndës është konstatuar se përfaqësuesja e autorizuar e ankuesve, Av. Teuta me datë 06.09.2022 përmes shkresës me numër protokollin 1913/2022, në emër të ankuesve i është drejtuar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me kërkesë për kompensimin e pagës jubilarë, shujtave ditore, dhe shtesave tjera, duke u bazuar në dispozitat

e Marrëveshjes se Përgjithshme Kolektive të Kosovës, ndërsa me datë 23.09.2022, e njëjta ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime të njëjta ankimore.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueseve analizoi dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenin 98 paragrafin 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj”, si dhe nenin 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtët ligj ku përcaktohet se: “1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.*

Rrjedhimisht, në kuptim të dispozitave të lartcekura ligjore, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e ankuesve e parashtruar me datë 23.09.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e paraafatshme, ngase e njëjta është parashtruar në kundërshtim me nenin 127 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që institucioni punëdhënës lidhur me kërkesën e ankuesve të datës 06.09.2022 ende nuk e kishte përfunduar procedurën administrative, respektivisht nuk kishte nxjerrë akt administrativ përpara se ankuesit të parashtrojnë ankesë në Këshill, sikurse që nuk është përmbushur as kriteri kohor ndërlidhur me heshtjen administrative, pasi që institucioni punëdhënës sipas dispozitave të lartcekura ligjore ka pasur afat kohor 45 ditë për trajtimin e kërkesës së ankuesve të datës 06.09.2022, ndërsa ankuesit ankesën në Këshill e kanë parashtruar me datë 23.09.2022 apo 17 (shtatëmbëdhjetë) ditë pas parashtrimit të kërkesës në kuadër të institucionit punëdhënës.


Kolegji i Këshillit nga të gjeturat e dhëna si më lartë, konstaton se ankesa e ankuesve e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 23.09.2022 është parashtruar në kundërshtim me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj e njëjta është hedhur poshtë si e palejuar si në dispozitiv të këtij vendimi pasi që nuk e plotëson kushtin e nevojshëm të pranueshmërisë së ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji.”*

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.819/2022

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësueses së autorizuar të ankuesve Avokates
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.

